

**Besarta Përzhaku**

# **MATEMATIKA 1**

**Libër për mësimdhënës/e**



**Botues:**

Shtëpia Botuese Shtypshkronja "BERATI"

**Për botuesin:**

Begri Abdullahu

**Dizajn Grafik:**

Edis Abdullahu

**Kopertina:**

Kenan Ilijazi

**Redaktor teknik:**

Berat Abdullahu

**Lektor:**

Fikret Ramaj

**Formati:**

21 x 29cm

**Shtypi:**

Shtypshkronja Berati Prizren

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të Kosovës e ka lejuar për botim dhe përdorim këtë tekst shkollor për klasën e parë me numër të vendimit:

**Të gjitha të drejtat janë të rezervuara © BERATI**

## **PËRMBAJTJE**

Hyrje – Qëllimi .....	3
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës 1 .....	4
Udhëzimet metodologjike .....	8
Teknikat dhe metodat e punës .....	9
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës.....	14
Planifikimi Vjetor .....	18
Plani Dymujor (Shtator-Tetor) .....	19
Plani Dymujor (Nëntor – Dhjetor) .....	24
Plani Tremujor (Janar-Shkurt-Mars) .....	27
Plani Tremujor (Prill-Maj-Qershor) .....	34
Aspektet të përgjithshme të planit të orës mësimore .....	38

## Hyrje

Të nderuar mësime/ndërmësues/e

Libri i mësuesit për lëndën e matematikës të klasës së parë është hartuar në bazë të planit lëndor për shkollën e parë të Kurrikulës, dhe paraqet mënyrën e zhvillimit të mësimit për fushën e matematikës. Është punuar me qëllim që t'iu vihet në ndihmë të gjithë mësime/ndërmësues/e që do ta përdorin këtë libër.

Për hartimin e librit janë përdorur veprimtari mësimore të ndryshme, strategji dhe teknika bashkëkohore të mësime/ndërmësues/e sipas planit të matematikës, ku si qëllim ka të nxënësit të nxitet të menduarit kritik, kreativ, zbulues, me idetë bazë për strukturat matematikore, si dhe t'iu zhvilloj atyre aftësitë për llogaritje dhe zgjidhje të problemeve në jetën e përditëshme.

Libri synon zhvillimin intelektual, aftësimin për të gjykuar nga këndvështrime të ndryshme, si dhe zhvillimi i imagjinatës dhe aftësisë krijuese.

Përmes strategjive dhe veprimtarive të nxitë zhvillimin e shkathtësive për të punuar në mënyrë të pavarur dhe të nxënimit ndërveprues, si dhe ndërtimin e njohurive të reja dhe të integritit me fusha të tjera.

Fusha / lënda e matematikës mbahet me nga 5 orë mësimore në javë, për 37 javë = 185 orë mësimore.

Ky tekst përmban:

- **Planin Vjetor**
- **Planet dymujore dhe tremujore**
- **Plane ditore ( Mësime modele)**
- **Teste**

Libri ofron mundësi realizimin e veprimtarive mësimore në klasë dhe udhëzon në vlerësimin e nxënësve duhet të jetë sistematik dhe motivues dhe duhet të përqendrohet në vlerësimin e nocioneve themelore matematikore.

Në këtë tekst jepen shembuj të zhvillimit të orës mësimore, por mësime/ndërmësues/e mund të krijojnë mjedis mësimor sipas niveleve të nxënësve, sipas faktorëve të tjerë që mund të ndikojnë në zhvillimin e orës mësimore.

Shpresoj që ky libër të ju shërbejë në punën tuaj të përditëshme!

# REZULTATET E TË NXËNIT PËR KOMPETENCAT KRYESORE TË SHKALLËS SË PARË

## FUSHA : MATEMATIKË

### LËNDA : MATEMATIKË

#### I Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv

1. Lexon me zë drejt një tekst letrar apo joletrar, të palexuar më parë.
2. Shkruan një tekst deri në një faqe (500 fjalë) e më shumë për një temë të caktuar.
3. Dëgjon në mënyrë aktive prezantimin e tjetrit dhe merr pjesë në diskutim, duke u paraqitur me të paktën dy ndërhyrje: pyetje, komente apo sqarime për temën e dhënë.
4. Shpreh qëndrimin për ngjarjen apo performancën dhe emocionet e veta që i ka përjetuar gjatë shikimit të një filmi, të një dokumentari të përshtatshëm për moshën e vet, gjatë leximit të një libri, një interpretimi muzikor, një ekspozite, një recitimi apo dramatizimi, në njërën nga format shprehëse, si : me të folur, me shkrim, me vizatim, me mimikë, me lëvizje etj.
5. Merr pjesë në organizimin e një shfaqjeje artistike në harmoni me moshën e vet, duke përdorur forma të ndryshme të të shprehurit.
6. Identifikon personazhet kryesore të një tregimi, drame, filmi, kënge apo ngjarjeje nga jeta, bën dallimin e tyre duke bërë një listë me vetitë që i pëlqejnë dhe që nuk i pëlqejnë tek ata, diskuton rreth tyre, performon rolin e njërit prej personazheve në bashkëveprim me moshatarë.
7. Shpreh, në formë verbal dhe të shkruar, fjali të thjeshta në gjuhë të huaj dhe përkthen në gjuhë amtare fjali të tjera të thjeshta që i dëgjon nga mjetet auditive, autovizuele apo nga mësimdhënësi në gjuhë të huaj të dhëna si detyrë.
8. Prezanton një temë të caktuar para të tjerëve në kohëzgjatje deri në 10 minuta duke përdorur TIK-un apo teknologji tjetër, u përgjigjet pyetjeve të bëra nga të tjerët si dhe bën pyetje gjatë dhe pas prezantimit, për të vazhduar më tej me kërkimin e informatave të tjera.

#### II Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ

1. Identifikon veçoritë e përbashkëta dhe dalluese ndërmjet objekteve, qenieve të gjalla, dukurive apo ngjarjeve, të dhëna në detyrë, i paraqet ato para të tjerëve përmes njëres nga format shprehëse.
2. Identifikon çështjet e njëjta, dalluese ose kryesore të një teme apo ngjarjeje të njëjtë, por të nxjerra nga dy e më shumë burime të ndryshme të informacionit (tekst mësimor, gazetë, internet, burime njerëzor apo burime të tjera).
3. Paraqet për diskutim argumentet për pajtueshmërinë ose kundërshtimin për një medium e qëndrim të shprehur apo sjellje të manifestuar nga një apo më shumë persona (në klasë/shkollë apo jashtë saj).
4. Zgjedh problemin dhe detyrën e dhënë nga gjuha, aritmetika, gjeometria, shkencë e natyrës, shoqëria ose fusha të tjera dhe jep një shembull e më shumë nga jeta e përditshme kur një qasje e tillë mund të përdoret në situatë të ngjashme.
5. Ndërton tekste, objekte, animacione apo gjëra të tjera në bazë të imagjinatës duke përdorur me kujdes udhëzimet dhe elementet apo materialet e dhëna.
6. Përshkruan dukurinë e caktuar ( natyrore, shoqërore – historike) në njërën nga format shprehëse, duke veçuar ndryshimet që ndodhin apo kanë ndodhur në mjedisin që e rrethon e që janë rrjedhojë e

kësaj dukurie.

7. Paraqet dhe arsyeton me argumente mënyrë e zgjidhjes së një problemi/detyrë të caktuar të fushave të ndryshme ( matematikore, gjuhësore, të shkencave të natyrës, shoqërore, të arteve, shëndetësore etj.) në kohëzgjatje prej 6-10 minutash.

8. Dallon lëndët, trupat, objektet, dukuritë natyrore apo shoqërore të dhëna në detyrë sipas karakteristikave (përbërjes, vetive, shëndërimeve apo pozitive në kohë e hapësirë dhe bashkëveprimet) të tyre.

### **III Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm**

1. Parashtron pyetje që nxisin debat për temën/problemin e dhënë dhe u jep përgjigje pyetjeve të bëra nga të tjerët përmes njërës nga format e shprehjes.

2. Shfrytëzon burime të ndryshme të informacionit me rastin e përgatitjes së një teme të caktuar.

3. Identifikon dhe krahason informatat e njohura me ato të panjohura, për një temë, çështje apo ngjarje të caktuar duke përdorur teknika të ndryshme ( psh., duke i shënuar me shenja të ndryshme).

4. Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në burime të tjera për të realizuar një veprim, aktivitet apo detyrë konkrete që kërkohet prej tij/saj.

5. Krahason përparimin e vet me përvojën paraprake gjatë kryerjes së një detyrë apo një aktiviteti të caktuar.

6. Përdor dosjen personale si mjet për identifikimin e përparësive apo mangësive të veta në fusha të caktuara dhe bën një plan për mënyrën e korrigjimeve të nevojshme.

7. Identifikon cilësitë e veta që i posedon dhe cilësitë e nevojshme që duhet t'i zhvillojë për të nxënë një detyrë apo një aktivitet të caktuar dhe për të bashkëpunuar me të tjerët.

8. Menaxhon sjelljet e veta, materialiet/mjetet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyrë/aktiviteti individual apo të përbashkët në klasë/shkollë apo jashtë saj.

9. Përdor dhe zbaton në mënyrë efektive informatën/njohurinë për zgjidhjen e një problem/detyrë të caktuar përmes shfrytëzimit të TIK-ut apo teknologjisë tjetër, prezanton përvojën e vet para të tjerëve për 6-10 minuta.

### **IV Kompetenca për jetë, punë dhe mjedis – Kontribues produktiv**

1. Përgatit një autobiografi në të cilën prezanton veten me të dhënat personale dhe me prirjet për fusha të caktuara duke i gjetur të përbashkëtat me profesionet e dëshiruara.

2. Përgatit një plan pune për një javë dhe specifikon aktivitetit më me prioritet duke arsyetuar përzgjedhjen e tyre.

3. Përgatit një projekt të vogël duke veçuar aktivitetet kryesore për një çështje që e preokupojnë atë, shkollën apo lagjen dhe përcakton elementet e tjera që e bëjnë më të zbatueshëm, si: kohën, vendin, materialiet, mjetet e nevojshme për bërjen/kryerjen e tyre etj.

4. Diskuton në grup për gjendjen e mjedisit që e rrethon, të inicuar më parë (si: vëzhgim, fotografim etj.) dhe bën një listë në bashkëpunim me anëtarët e grupit për aktivitetet e mundshme mbi mbikëqyrjen dhe përmirësimin e gjendjes.

5. Debaton me moshatarë për mënyrën e sjelljes së nxënësve në klasë/laborator, në shkollë dhe në mjedise të tjera apo për një grup të caktuar njerëzish për një situatë të caktuar duke mbrojtur idetë e

veta me shembuj konkretë.

6. Identifikon ushqimet më të shpeshta, materialet e tjera shpenzuese të familjes apo harxhimet vetjake dhe llogarit shpenzimet për një javë, të dhënat e gjetura i paraqet në formë tabelare/grafike apo në një formë tjetër.

7. Lexon etiketen, udhëzuesin e produkteve të ndryshme (rrobave, ushqimit, barnave apo të teknikës) dhe jep sqarim për prejardhjen, përmbajtjen, përdorimin, mënyrën e mirëmbajtjes apo për rreziqet në rast mospërdorimit të drejtë/adekuat.

8. Paraqet në formë tabelare, grafike, të vizatimit apo në një formë tjetër, aktivitetet e kujdesit që i bën ndonjë qenieje të gjallë, të cilat i mundësojnë zhvillimin, rritjen apo ruajtjen e shëndetit të tij/saj.

## **V Kompetenca personale – Individ i shëndoshë**

1. Prezanton para të tjerëve mënyrën e zbatimit të rregullave themelore të higjienës personale (fizike, të veshëmbathjes, të gjësendeve personale) dhe të higjienës së mjedisit, ku jeton dhe vepron, përmes formave të ndryshme të shprehjes.

2. Merr pjesë në aktivitete fizike-lojëra lëvizore dhe lojëra sportive, bën përpjekje për arritjen e standarteve të përcaktuara, luan fer, menaxhon emocionet e veta dhe prezanton para të tjerëve gjendjen fizike dhe shpirtërore pas realizimit të një aktiviteti fizik apo loje sportive.

3. Përgatit një listë (me njërën nga format e shprehjes, shkrim, vizatim etj.) me ushqime të cilat i konsumon familja duke i renditur ato sipas kalorisë dhe më pas i klasifikon në ushqime të shëndetshme dhe më pak të shëndetshme.

4. Lexon të dhënat në paketim të ushqimit dhe diskuton në grup për këto të dhëna (vlerat ushqyese, afatet e prodhimit etj.)

5. Identifikon: përparësitë dhe mangësitë e personalitetit të vet dhe jep mendime për mënyrën e përmirësimit, në forma të ndryshme shprehëse.

6. Propozon alternativa për zgjidhjen konstruktive të një konflikti ndërpersonal duke i analizuar paraprakisht me kujdes rrethanat që kanë shkaktuar konfliktin, ndan përvojat, mendimet dhe ndjenjat e veta me anëtarët e grupit.

7. Dallon dhe përshkruan rolet e personave dhe shërbimeve të nevojshme për kërkimin e ndihmës në situatë të caktuara të rrezikut të shëndetit të vet, fizik dhe mendor.

8. Bashkëpunon në mënyrë aktive me të gjithë moshatarët (pavarësisht prejardhjes së tyre, aftësive dhe nevojave të veçanta) për arritjen e një qëllimi të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj).

9. Përkujdeset për mjedis të shëndoshë në rrethanat në të cilat realizon një aktivitet të caktuar duke i krijuar vetes dhe pjesëmarrësve të tjerë kushte të përshtatshme të punës (ajrosje, shfrytëzim të dritës, shfrytëzim maksimal të hapësirës, mbajtje të pastërtisë, mbajtja e rregullt e sendeve që e rrethojnë etj.)

## **VI Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm**

1. Paraqet në forma të ndryshme të drejtat dhe përgjegjësitë e pjesëtarve të familjes së vet dhe i diskuton ato me të tjerët, më pas i krahason me të drejtat dhe përgjegjësitë e nxënësve, mësuesve

dhe staf menaxhues në shkollë apo me pjesëtarët e ndonjë institucioni.

2. Shpreh, dëgjon dhe respekton mendimin e secilit anëtar dhe bashkërisht vendos për mënyrat e përfudimit të një aktiviteti të përbashkët.

3. Propozon vlera shoqërore, që janë të rëndësishme të kultivohen në klasë, në shkollë apo në familje ( si psh. besimi i ndërsjellë, tolerance, solidariteti, respekti-mirësjellja etj.) dhe me shembull konkret përshkruan ndonjë situatë ku gjen shprehje ndonjëra nga ato.

4. Manifeston veprime që shprehin mirësjellje në situatë të ndryshme dhe me shembull konkret tregon përdorimin e tyre në klasë/shkollë, në familje e në komunitet.

5. Propozon dhe ndan mendimin me shokët/shoqet e klasës për procedurën e zgjedhjes së anëtarëve të grupeve të aktiviteteve të ndryshme me karakter mësimor, të këshillave në klasë apo në shkollë përbërjen dhe rolin e tyre.

6. Merr pjesë në hartimin e rregullave të lojës, në klasë, në shkollë ( psh., si propozues rregullash, menaxhues i propozimeve nga të tjerët etj.) dhe argumenton rëndësinë e respektimit të ndonjerës rregull të propozuar në formë të ndryshme të shprehjes, duke parashikuar pasojat e moszbatimit të saj.

7. Identifikon dy e më shumë organizime shoqërore dhe përshkruan ( në formë të shkruar apo në ndonjë formë tjetër) mënyrat/mundësitë se si njerëzit e ndryshëm me përvoja të ndryshme mund të organizojnë diçka të përbashkët.

8. Prezanton në mënyrë kronologjike ndryshimet e familjes dhe të rrethit në aspekte të ndryshme (si: objektet e banimit, festat, veshjet, ushqimet-mënyra e të ushqyerit, menaxhimi I ekonomisë familjare, të drejtat, përgjegjësitë dhe vendimarrja në familje etj.) ose disa nga personalitet dhe ngjarjet kryesore të popullit të vet, duke e dalluar të tashmen nga e kaluara.

9. Paraqet me shembuj konkretë sjelljet që duhet manifestuar në rast rreziku nga fatkeqësitë natyrore apo të krijuara nga njeriu, si: zjarri, vërshimi, tërmeti, komunikimi me njerëz të panjohur etj.

## **Udhëzime metodologjike**

Për të arritur sa më lehtë realizimin e përmbajtjes së lëndës matematikës, mësuesi përzgjedh metodologjitë më adekuate si dhe brenda saj përdor teknika dhe forma të ndryshme duke iu përshtatur moshës, nevojave dhe mundësive të nxënësve. Në bazë të përmbajtjes së temave mësuesi përdor mjete, materiale dhe prova të ndryshme me qëllim të realizimit të aktiviteteve në mënyrë praktike në formë të aktiviteteve dhe lojërave. Lënda, Matematika kërkon nga mësuesi një qasje menaxhuese duke përdorur forma ndërvepruese, gjithëpërfshirëse, ekipore dhe krijuese gjatë mësimit dhe mësim nxënies.

Mësimdhënia dhe mësimnxënia cilësore kërkon qasje metodologjike si më poshtë:

- Mësimdhënie dhe nxënie me nxënësin në qendër dhe gjithëpërfshirje;
- Mësimdhënie dhe nxënie të bazuar në qasjen e integruar;
- Mësimdhënie dhe nxënie të bazuar në arritjen e kompetencave;
- Mësimdhënie dhe nxënie të diferencuar;
- Çështje/tema ndërkurrikulare të diferencuar;



- Në çështje jashtë kurrikulare.

Në të gjitha rastet zbatimi i metodologjisë kërkon përdorimin e teknikave, materialeve dhe mjeteve didaktike pa të cilat nuk mund të arrihen rezultatet e pritura për këtë nivel-klasën e pestë, duke realizuar praktikat me të mira mësimore.

Mësimdhënia e shkencave të natyrës, duke e vendosur nxënësin në qendër të të nxënës, synon të nxitë qëndrime pozitive ndaj shkencës. Mësuesi/ja duhet të përdorë strategji mësimdhënieje, që e përfshijnë nxënësin. Këto strategji mësimdhënieje do të grupoheshin në këtë mënyrë:

### **Teknikat dhe metodat e punës në grup**

#### **Teknikat dhe metodat e hulumtimit**

#### **Teknikat dhe metodat për zhvillimin e të menduarit kritik dhe krijues**

*Teknikat dhe metodat e punës në grup* u japin mundësinë nxënësve, që të realizojnë qëllimet mësimore duke bashkëvepruar me të tjerët. Këto teknika kanë në thelb të tyre ndërveprimin dhe sigurojnë kushte që nxënësittë paraqesin idetë, pikëpamjet e veta dhe informacionin që ata zotërojnë

- Mendo/krijo, puno në dyshe
- Punë në grupe
- Grupet e ekspertëve
- Loja me role
- Lëviz, ndalo, krijo dyshe
- Lexim përmbledhje në grupe dyshe
- Tryeza rrethore

#### **1. Lexim përmbledhje në dyshe. Pyet - shkëmbe mendim - puno në grupe dyshe**

Është një metodë që në përgjithësi përdoret gjatë ndërtimit të njohurive. Mësuesi/ja organizon nxënësit në dyshe.

- Mësuesi/ja përgatit fleta pune për secilën dyshe.
- Njeri bën pyetjen, tjetri përgjigjet ose njëri lexon një paragraf tjetri e përmbledh shkurt me fjalët e veta. Në një moment të dytë, nxënësit mund të ndërrojnë rolet.

#### **2. Grupet e ekspertëve**

Është një metodë që mund të përdoret në fazën e ndërtimit të njohurive.

- Mësuesi/ja ndan klasën në katër grupe, pastaj duke numëruar në mënyrë rastësore nga 1-4 përcaktonekspertet, ku çdo numër i korrespondon një eksperti.
- Mësuesi/ja harton katër pyetje për çdo grup pune, ku një pyetje i takon një eksperti.
- Në këtë moment, ekspertët me numrin 1 mbliidhen në një tavolinë për t'i dhënë përgjigje pyetjes numër 1, ekspertët me numrin 2 do mbliidhen bashkë për pyetjen numër 2 ... e kështu me radhë.
- Pasi të kenë mësuar shumë mirë përgjigjen, ekspertët kthehen në grupin fillestar, ku do t'ua mësojnëpyetjen edhe ekspertëve të tjerë të grupit.
- Në fund, eksperti 1 do të japë përgjigjen e ekspertit 2 e në vazhdim.

#### **3. Loja me role**

Është një metodë që, në përgjithësi, përdoret në fund të orës së mësimin.

- Organizohen nxënësit në grupe sipas aftësive që shfaqin, p.sh grupi i politikanëve, grupi i

ekonomistëve, grupi i menaxherëve etj.

- Në një kohë të dytë mund të riorganizohen dhe të krijojnë grupe të reja me secilin përfaqësues sipasgrupeve të interesit.
- Mund të përdoret për punët praktike apo projektet.

#### **4. Lëviz - ndalo - krijo në grupe dyshe**

Është një teknikë që mund të përdoret në fillim ose në fund të orës së mësimit.

- Para nxënësve shtrohet një pyetje.
- Sapo jepet komanda 'lëviz', nxënësit lëvizin për të krijuar dyshe.
- Jepet komanda 'ndalo', nxënësit ndalojnë dhe fillojnë të diskutojnë me njëri-tjetrin për të marrë përgjigjete duhura.
- Pastaj brenda secilës dyshe, secili flet për përgjigjet që mori nga shoku i vet.
- Kjo teknikë mund të përdoret edhe për të hartuar pyetje që nuk kanë lidhje me mësimin, në mënyrë qënxënësit të shkarkohen nga emocionet.

#### **5. Tryeza rrethore**

Është një metodë që mund të përdoret në fund të orës së mësimit.

- Mësuesi/ja ndan klasën në disa grupe (ose i vendos në formë rrumbullake).
- Në secilin grup, një nxënës fillon lojën i pari; ai mund të shkruajë një substancë kimike, p.sh. hekur, squfur, azot.
- Pasi plotësohet nga nxënësi i parë, letra paloset dhe i jepet shokut pasardhës në mënyrë që të vazhdojë në plotësimin e idesë.
- Në fund të kësaj loje, nxënësi/ja i/e fundit hap letrën dhe e lexon të gjitha mendimet e dhëna.

#### **1. *Teknikat dhe metodat e hulumtimit***

##### **Studimi i rastit**

- Konsiston në studimin e hollësishëm të një rasti apo situatë të veçantë.

##### **Puna me projekte**

- Projektet janë investigim i pavarur nga ana e nxënësve për një periudhë pak a shumë të gjatë kohore. Ato janë veprimtari të nxëni që kërkojnë që nxënësit të zbulojnë rreth objekteve, proceseve apo dukurive.

##### **Ekskursioni/vëzhgime**

- Kryhet me qëllim që nxënësit të njohin objektet, dukuritë dhe proceset në mjedisin natyror, është mënyra më e mirë për të bërë mësime real.

##### **Lojërat**

- Lojërat angazhojnë nxënësin në simulime për të nxënëit e koncepteve apo për zhvillimin e aftësive dhe të qëndrimeve. Ato përdoren për të ndihmuar nxënësin në vizualizimin apo ilustrimin e objekteve të botës reale.

## Hetimi / Punë praktike

- Nxënësi/ja angazhohet në veprimtari përmes të cilave kuptojnë se si shkencëtarët mendojnë dhe çfarë bëjnë në një proces vendimmarrje, si ngrenë pyetje dhe si planifikojnë hetimin, si zhvillojnë qëndrimet dhe vlerat që janë themelore për praktikimin e shkencës.

## Zgjidhja e problemit

- Zgjidhja e problemit e angazhon nxënësin për gjetjen e zgjidhjeve të problemeve duke zbatuar njohuritë shkencore.

## Historitë/tregimet

- Historitë apo tregimet rreth shkencës në jetën e përditshme nxisin interesin e nxënësit dhe e angazhojnë atë në biseda. Mësuesi ose nxënësi mund të krijojnë vetë histori apo tregime.

### II. Teknikat dhe metodat për zhvillimin e të menduarit kritik dhe krijues

- Metoda të zhvillimit të aftësive folëse (shprehëse)
- Metoda të zhvillimit të aftësive lexuese
- Metoda të zhvillimit të aftësive shkruese

## Aftësitë shprehëse

### 1. *Brainstorming / Kllaster*

Është një metodë, e cila përdoret për të nxitur dhe përftuar sa më shumë ide të reja rreth një teme.

- Mësuesi shkruan idetë e nxënësve në tabelë, pa i paragjykuar ato. Kjo ndihmon në “hapjen e mendjevetë nxënësve”.
- Jo të gjitha idetë që ata do të japin do të jenë njëlloj të dobishme. Është e ngjashme me kllasterin, por në kllaster shkruajmë në tabelë vetëm ato që janë të domosdoshme.
- Mund të përdoret në fillim ose në fund të mësimit.

### 2. *Parashikim me terma paraprakë*

Është një metodë, e cila përdoret për të ngacmuar imagjinatën e nxënësve në fillim apo në fund të mësimit.

- Mësuesi/ja jep disa fjalë nxënësve (mund të mos jenë të gjitha fjalë kyçe).
- Ju lë pesë minuta kohë që me këto fjalë të krijojnë një tregim (shkrim, paragraf) të shkurtër.
- Lexohen disa nga punimet më të mira.

### 3. *“Karrigia e nxehtë”*

Është një metodë, e cila mund të përdoret më shumë në fund të orës së mësimit.

- Një (ose disa nxënës me radhë) mund të ulet në një karrige para klasës, ndërkohë që gjithë nxënësit etjerë hartojnë pyetje dhe ia drejtojnë atij.
- Synon në përforcimin e dijeve të marra.

### 4. *Dy të vërteta, një gënjeshtër*

Është një teknikë, e cila mund të përdoret më shumë në fund të orës së mësimit.

- Mësuesi/ja fillon lojën, liston tri karakteristika, veti, tipare në lidhje me një koncept të caktuar dhe ftonnjërin nga nxënësit që të thotë nëse pohimet e tij/saj janë të vërteta apo jo.
- Ky nxënës që e vazhdon më tej lojën në të njëjtën mënyrë.
- Synohet që në lojë të përfshihen sa më shumë nxënës.

### **5. Di Dua të di Mësova - Çfarë? Ëhë çfarë? Po tani, çfarë?**

Është një metodë e cila mund të përdoret gjatë gjithë orës së mësimit.

- Janë sa të ngjashme, aq edhe të ndryshme nga njëra-tjetra; ndryshimi qëndron në faktin se te teknika e dytë, në momentin e përfundimit ‘po tani çfarë’, duam të diskutojmë për diçka praktike, kërkojmë një konkluzion praktik.

<b>Di /çfarë dinim</b>	<b>Dua të di /çfarë duam të dimë</b>	<b>Mësova/çfarë mund të bëjmë nërealitet</b>
<b>Çfarë dinim</b>	Çfarë duam të dimë	Po tani çfarë (çfarë mund të bëjmë, çfarë detyre del)
<b>Parashikim</b>	Ndërtim njohurish	Përfundim

### **6. Rrjeti i diskutimit / Kundërshtia akademike**

Janë dy teknika që preferohet të përdoren në përgjithësi në fund të orës, që synojnë në hartimin e një pyetje në formën ‘A duhet...?’.

- Nxënësit në mënyrë të lirshme sjellin argumentet për t’u përgjigjur me “po” ose “jo”.
- Kur mësuesi/ja kërkon që një grup nxënësish të sjellë argumente për po/jo, pavarësisht se çfarë atamund të besojnë.

### **7. Imagjinatë e drejtuar**

- Është një metodë, e cila mund të përdoret shumë mirë në fillim të orës së mësimit për të ngacmuarsadopak imagjinatën e nxënësve.
- Mësuesi/ja kërkon nga nxënësi të imagjinojë një objekt, veprim, udhëtim në kohë që ka lidhje direkt me temën mësimore.
- Nxënësi/ja mund të shprehet me fjalë ose ndoshta dhe me një vizatim të thjeshtë.

### **8. Diskutimi i njohurive paraprake**

Teknikë që synon kontrollin e njohurive nga mësuesi ose vetë nxënësit me njëri-tjetrin.

### **9. Pyetja sjell pyetjen**

Është teknikë që gjen zbatim më shumë në fazën e ndërtimit të njohurive.

- Mësuesi/ja bashkë me nxënësit bëjnë pyetje të njëpasnjëshme njëri-tjetrit në formën e një reaktionizinxhir.
- Pyetjet hartohen në mënyrë të tillë që të ndjekin në mendim njëra-tjetrën dhe të synojnë të arrijnëqëllimin final.

**Aftësitë lexuese**

### 1. **INSERT - Interactive Notice System for Effective Reading and Thinking**

Nëpërmjet kësaj metode nxënësit kuptojnë atë që lexojnë. Gjatë leximit nxënësit vendosin shenja (+, -) të cilat kanë një domethënie të caktuar.

### 2. **Harta e koncepteve / Organizues grafik**

Organizohet në tabelë që të bëhet më i kuptueshëm. Në tabelë vendosen: koncepti, përkufizimi, karakteristikat etj. Harta e koncepteve mund të jetë e formave të ndryshme

#### **Aftësitë shkruese**

##### 1. **Ditari dypjesësh / ditar trepjesësh**

- Mësuesi/ja organizon nxënësit në grupe pune që mund të jenë me nga dy ose me më shumë nxënës.
- Të përgatisë fleta pune për nxënësit sipas grupeve përkatëse.
- Çdo fletë do të ketë një pyetje, për të cilën kërkohet komenti nga ana e nxënësit.
- Nxënësit plotësojnë kolonën “komente” duke përdorur njohuritë e marra nga teksti.
- Fletët e punës të përgatitura për nxënësit duhet të jenë si më poshtë.

<b>Pyetja</b>	<b>Komenti i nxënësve</b>

Nëse koncepti nuk mund të përvetësohet plotësisht nga nxënësi dhe ka nevojë edhe për një koment nga ana e mësuesit, fleta e punës do të kishte një formë si më poshtë.

<b>Pyetja</b>	<b>Komenti i nxënësve</b>	<b>Komenti i mësuesit</b>

##### 2. **Diagrami i Venit**

- Shërben për krahasimin e koncepteve dhe dukurive të ndryshme.

##### 3. **Pesëvargëshi**

Kjo teknikë mund të përdoret në fillim ose në fund të orës së mësimit.

- Shkruhet emri i temës apo një emër që ka të bëjë me temën.
- Emri shoqërohet nga 2 mbiemra, 3 folje, 1 fjali dhe me sinonimin përkatës.

##### 4. **Esetë dhe shkrimet e lira**

- Kjo teknikë lidh shumë mirë shkencat natyrore me ato shoqërore.
- Mund të përdoret në fillim ose në fund të orës së mësimit.
- Esetë mund të jenë krahasuese, argumentuese, përshtuese.

**5. *Shkrimi i shpejtë/shkrimi i lirë***

- Kjo teknikë përdoret në fund të orës mësimore për të testuar njohuritë e marra.

Mësuesi/ja citon njohurinë dhe nxënësit pa ndalur dorën për tre minuta shkruajnë çfarë mbajnë mend.

## REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS KOMPETENCAVE TË FUSHËS

Njohuritë, të kuptuarit dhe shkathtësitë që zhvillohen të nxënësi/ja përmes përvojave mësimore që ndërlidhen me:	Përshkrimi i kompetencave	Zhvillimi i kompetencave nëpërmjet tematikave
1. Zgjidhja e problemeve	Nxënësi ndërton njohuri, përshkruan dhe zgjidhë situata problemore që krijohen brenda matematikës dhe në kontekste nga fushta e tjera si dhe nga përvojat e përbashkëta të jetës së përditshme.	<p style="text-align: center;">Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përshkruan kërkesat e problemeve të thjeshta;</li> <li>• Përdor mjete dhe metoda të thjeshta për matjen e formave 2d (d-dimensionale) dhe objekteve 3d;</li> <li>• Kryen veprimet themelore matematikore me numrat deri në dyshifrorë</li> <li>• Zhvillon, përzgjedh dhe zbaton strategjitë e zgjidhjes së problemave;</li> <li>• Bën vrojtime, hetime, që ndihmojnë në të kuptuarit e njohurive dhe zotërimin e shprehive matematike.</li> </ul>
2. Arsyetimet dhe vërtetimet matematike	Nxënësit përdorin arsyetimin, argumentimin dhe vërtetimin si aspekte themelore të matematikës.	<p style="text-align: center;">Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Nxjerr rregullat, arsyeton konceptet dhe modelet e thjeshta matematikore, për të hapur rrugën për koncepte të reja;</li> <li>• Zhvillon dhe zbaton shprehi të arsyetimit si klasifikim, dallim i marrëdhënieve, përdorimi empirik i kundërshebullit;</li> <li>• Hamendëson dhe gjykon hamendësinme;</li> <li>• Argumenton dhe mbron argumentin.</li> </ul>
3. Komunikimi në/përmes matematikës/s	Nxënësve iu mundësohet përdorimi i komunikimit nëpërmjet shenjave, të folurit të lexuarit, të shkruarit,	<p style="text-align: center;">Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdor gjuhën natyrore dhe simbolet matematikore për të organizuar fakte, konceptet, idetë dhe veprimet themelore në matematikë; për të diskutuar me</li> </ul>

	<p>diskutimit, të dëgjuarit, të pyeturit për të organizuar dhe qartësuar të menduarit matematik.</p>	<p>bashkëmoshatarët për rezultatet dhe sfidat e punës së tij;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përforcon strukturat mendore të ndërtuara më parë, të përshtatshme për matematikën duke parashtruar, pranuar dhe përgjigjur pyetjeve.</li> <li>• Përdor algoritmin e veprimeve me numra për të bërë njehsime me mend.</li> <li>• Komunikon të menduarin e tij matematik (nëpërmjet të lexuarit, të shkruarit, diskutimit, të dëgjuarit, të pyeturit) duke përdorur: gjuhën e përditshme, fjalorin fillestar matematik, paraqitje të ndryshme.</li> <li>• Komunikon të menduarin e tij matematik, duke përdorur simbole matematike.</li> <li>• Krijon paraqitje të koncepteve matematike me mjete konkrete, vizatime numra, simbole, tabela, diagrame.</li> <li>• Lidh konceptet mes tyre dhe i zbaton në zgjidhje problemash.</li> </ul>
<p>4. Lidhjet matematike</p>	<p>Nxënësve iu mundësohet për të njohur dhe të përdorur lidhjet e ideve matematikore, për të kuptuar se si idetë matematikore ndërtohen njëra mbi tjetrën dhe për të prodhuar një tërësi koherente si dhe zbatimin e matematikës në kontekste brenda</p>	<p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Bën lidhje mes njohurive paraprake dhe të reja për ndërtimin e koncepteve të reja në lidhje me numrat deri në dyshifrorë, të formave 2d dhe objekteve 3d.</li> <li>• Bën lidhje të njohurive dhe shprehive matematike me situata ose dukuri të marra nga jeta e përditshme, lëndët e tjera, sportet etj;</li> <li>• Bën lidhje ndërmjet koncepteve e procedurave matematikore.</li> </ul>



	dhe jashtë fushës së matematikës.	
5.Përfaqësimet matematike	Nxënësve iu mundësohet për të krijuar dhe përdorur përfaqësitë për të organizuar, regjistruar dhe komunikuar idetë matematikore, zigjidh, përkthye dhe zbatuar përfaqësimet që kanë të bëjnë me zgjidhjen probleme matematikore, përdorur përfaqësimet për modele dhe interpretime të fenomeneve, sociale natyrore dhe matematikore.	<p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Identifikon rregullat themelore për njehsimet me numrat; kupton përdorimin e ndryshoreve për zgjidhjen e problemeve nga matematika dhe nga jeta e përditshme</li> </ul>
6.Modelimi matematik	Nxënësve iu mundësohet për të krijuar dhe të përdorur modelet të ndryshme, paraqit modelet dhe roli i tyre në kontekst, përdor modelet për të përfaqësuar dhe për të kuptuar marrëdhëniet sasiore, interpretuar me modele fenomenet, sociale natyrore dhe matematikore.	<p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përshkruan dhe krijon modele duke përdorur veprimet themelore matematikore në situata të përditshme( p.sh. ekonomisë familjare, statistika elementare për jetë etj.) që lidhen me numrat deri në dyshifrorë, format 2d dhe objekteve 3 d;</li> <li>• Identifikon rregullat themelore për njehsimet me numrat;</li> <li>• Kupton përdorimin e ndryshores për zgjidhjen e problemeve nga matematika dhe jeta e përditshme.</li> </ul>
7.Strukturimi i të menduarit matematikë	Nxënësve iu mundësohet për të	Nxënësi/ja:

	ndërgjegjësuar për mënyrën, formën, qasjen dhe për llojet e pyetjeve që e karakterizojnë matematikën si dhe llojet e përgjigjeve të pritshme.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Demonstron të menduar të pavarur dhe shprehi pune; forcon strukturat mendore të ndërtuara më parë, relevante për matematikën duke parashtruar, duke pranuar dhe duke iu përgjigjur pyetjeve.</li> </ul>
8.Përdorimin e TIK-ut në/për matematikë	Nxënësve iu mundësohet për të përdorë teknologjinë si mjet për të zgjidhur apo verifikuar zgjidhjet si dhe për të mbledhur, komunikuar e zbuluar informacione.	<p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Verifikon rezultatin e problemeve matematikore duke përdorur kalkulatorin për të provuar saktësinë;</li> <li>• Përdor kalkulatorin për gjetjen e rezultateve kur ka të bëjë me numra të mëdhenj.</li> </ul>

## PLANIFIKIMI VJETOR

### FUSHA E KURRIKULËS: MATEMATIKË

#### KLASA : E PARË

<b>Lëndët e fushës kurrikulare</b>	<b>TEMAT MËSIMORE TË SHPËRNDARA NË DY GJYSMËVJETORË GJATË VITIT MËSIMOR</b>				Kontributi në rezultatet e të nxënimit për kompetenca kryesore për shkallën e parë ( <i>klasa I</i> )
	<b>GJYSMËVJETORI PARË</b>		<b>GJYSMËVJETORI DYTË</b>		
	<b>Shtator-Tetor</b> 44 orë	<b>Nëntor-Dhjetor</b> 37 orë	<b>Janar-Shkurt-Mars</b> 58 orë	<b>Prill - Maj-Qershor</b> 46 orë	
<b>Lënda: Matematikë</b>	Orientimi  Bashkësitë dhe relacionet  Numrat natyrorë	Numrat natyrorë  Figurat gjeometrike	Numrat natyrorë  Figurat gjeometrike  Sipërfaqja  Modelet  Trupat gjeometrikë	Numrat natyrorë  Puna me të dhëna  Ekuacionet dhe inekuacionet lineare  Shprehjet shkronjore  Njësitë matëse	Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit- <b>Komunikues efektiv</b> <b>1,3,7,8</b> Kompetenca e të menduarit- <b>Mendimtar kreativ</b> <b>1,2,3,4,7,8</b> Kompetenca e të nxënimit- <b>Nxënës i suksesshëm</b> <b>1,2,3,4,5,6,7</b> Kompetenca për jetë, punë dhe për mjedis- <b>Kontribues produktiv</b> <b>2,4,5</b> Kompetenca personale- <b>Individ i shëndosh</b> <b>2,5,7</b> Kompetenca qytetare- <b>Qytetar i përgjegjshëm</b> <b>2,6</b>



3	Numrat natyrore	<p>grumbull objektesh;</p> <p>- Identifikon objektet që janë brenda ose jashtë bashkësisë;</p> <p>-Paraqet bashkësinë përmes diagramit të Venit;</p> <p>-Krijon bashkësi bazuar në cilësitë e objekteve (elementeve);</p> <p>-Krahason bashkësitë duke përdorur shprehjet; më shumë, më pak, aq sa;</p> <p>-Shoqëron objektet (elementet) e një bashkësie të dhënë me objektet (elementet) e një bashkësie tjetër;</p> <p>-Formon bashkësi nga dy bashkësi të dhëna.</p>	<p>majtas (Zh) fq.10,11</p> <p>6. Kuptimet: lart, poshtë, djathtas dhe majtas (U) fq.12</p> <p>7.Kuptimet: më i madh, më i vogël (Zh) fq.13</p> <p>8.Kuptimet: brenda, jashtë dhe në (Zh) fq.14</p> <p>9.Vlerësojmë atë që mësuam (V) fq.15</p> <p>10.Bashkësia, elementet e bashkësisë (Zh) fq.16</p> <p>11.Numërimi i elementeve që formojnë një bashkësi (Zh) fq.17</p> <p>12.Bashkësia, elementet e bashkësisë (U) fq.18</p> <p>13.Paraqitja e bashkësisë në diagram (Zh) fq.19</p> <p>14.Paraqitja e bashkësisë në</p>		<p>*Mësimdhënia dhe të nxënit e integruar</p> <p>*Mësimdhënia dhe të nxënit e diferencuar</p> <p><b>Metodat:</b></p> <p>Ilustrimit</p> <p>Demonstrimit</p> <p>Bashkëbisedimit</p> <p>Modelimit</p> <p><b>Teknikat:</b></p> <p>Stuhi mendimësh</p> <p>Rrjeti i diskutimit</p> <p>Kllaser</p>	<p><i>Lista e kontrollit</i></p> <p><i>Portfolio</i></p>	<p><b>Çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore</b></p> <p>-Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm</p> <p>-Edukimi për qytetari demokratik</p>	
---	-----------------	--	---	--	---	--	---	--

	<p>-Lexon dhe shkruan numrat nga 1 deri në 20;</p> <p>-Numëron në rendin rritës dhe zbritës me numrat nga 1 deri në 20;</p> <p>-Kupton shenjat; +, -, &gt;, &lt;, =, dhe i përdor ato në rastet e caktuara;</p> <p>- Demonstron të kuptuarit e numrit përmes shoqërimit me objekte/vizatime;</p> <p>-Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 20 duke përfshirë edhe numrin 0);</p> <p>-Zgjidh</p>	<p>diagram (U) fq.20</p> <p>15.Numri i elementeve të bashkësisë (Zh) fq.21</p> <p>16. Numri i elementeve të bashkësisë (U) fq.22</p> <p>17.Bashkësitë me numër të njëjtë të elementeve (Zh) fq.23</p> <p>18. Bashkësitë me numër të njëjtë të elementeve (U) fq.24</p> <p>19.Formimi i bashkësive nga dy bashkësi të dhëna(Zh) fq.25</p> <p>20.Detyra të ndryshme lidhur me bashkësitë fq.26</p> <p>21.Kuptimet: më shumë se, më pak se dhe aq sa (Zh) fq.27</p>	<p>Punë e drejtuar (me tekstet mësimore dhe ilustrime të përgatitura nga mësuesja)</p>			
--	---	--	--	--	--	--

	<p>problema të thjeshta bazuar në modelet e dhëna;</p>	<p>22.Vlerësojmë atë që mësuam (V) fq.28</p> <p>23.Numri një-1 (Zh) fq.29</p> <p>24. Numri dy-2 (Zh) fq.30</p> <p>25. Numri tre-3 (Zh) fq.31</p> <p>26.Numrat: 1, 2dhe 3(U) fq.32,33</p> <p>27.Numri katër-4 (Zh) fq.34</p> <p>28. Numri katër-4 (U) fq.35</p> <p>29.Vlerësojmë atë që mësuam (V) fq.36</p> <p>30.Numri zero-0 (Zh) fq.37</p> <p>31.Numrat nga 0 deri 4 (U) fq.38</p> <p>32.Shenjat:m ë e madhe, më e vogël (Zh) fq.39</p> <p>33.Shenja e bara-</p>					
--	--	---	--	--	--	--	--

			<p>zimit (Zh) fq.40</p> <p>34. Shenjat &lt;, &gt; dhe = (U) fq.41,42</p> <p>35. Mbledhja e numrave (Zh) fq.43,44</p> <p>36. Mbledhja e numrave deri në 4 (U) fq.45,46</p> <p>37. Zbritja e numrave (Zh) fq.47</p> <p>38. Zbritja e numrave (U) fq.48</p> <p>39. Detyra për përsëritje (P) fq.49,50</p> <p>40. Vlerësojmë atë që mësuam (V) fq.51</p> <p>41. Numri pesë-5 (Zh) fq.52,53</p> <p>42. Numrat deri në pesë (U) fq.54</p> <p>43. Mbledhja e numrave deri në 5 (Zh) fq.55</p>				
--	--	--	--	--	--	--	--



			44.Mbledhja e numrave deri në 5  (U) fq.56					
--	--	--	--	--	--	--	--	--

**PLANI DYMUIJOR: NËNTOR-DHJETOR**

**Fusha e kurrikulës: Matematikë Lënda mësimore: Matematikë Klasa: I**  
**Tema/ t mësimore: 1. Numrat natyrorë ; 2. Figurat gjeometrike**

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellitimit të temës/ve: I.3 ; II.2,8 ; III.1,2,3,4,5,7 ; IV.2,5 ; V.5,7 ; VI.2,6**

**Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellitimit të temës/ve: 1.1,4,5 ; 2.1 ; 3.1,2,3,4,5,6 ; 4.2 ; 5.1 ; 6.3 ; 7.1 ; 8.1**

Nr	Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësità mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndëtjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
1 . 2 .	Numrat natyrorë  Figurat gjeometrike	Lexon dhe shkruan numrat nga 1 deri në 20; -Numëron në rendin rritës dhe zbritës me numrat nga 1 deri në 20; -Kupton shenjat; +, -, >, <, =, dhe i përdor ato në rastet e caktuara; - Demonstron të kuptuarit e numrit përmes shoqërimit	<b>Muaji nëntor – dhjetor</b>  45.Zbritja e numrave deri në 5 (Zh) fq.57  46. Zbritja e numrave deri në 5 (U) fq.58  47.Mbledhja dhe zbritja e numrave deri në pesë-5 (U) fq.59  48.Detyratë ndryshme lidhur me mbledhje	37 orë	<b>Metodologjitë:</b>  *Mësimdhënia dhe të nxënit me nxënësin në qendër dhe gjithëpërfshirja  *Mësimdhënia dhe të nxënit e bazuar në arritjen e kompetencave	*Vlerësimi i vazhdueshëm  <i>*Vlerësim formativ</i>  <i>Përmes</i>  <i>- vezhgimit</i>  <i>- pjesëmarrjes në aktivitetet</i>  <b><i>Instrumentet:</i></b>	Gjuhët dhe komunikimi  Artet  Matematika  Ed.fiz.sport dhe shëndeti  Shoqëria dhe mjedisi  Jeta dhe puna	Matematika la  Buri me nga inter neti

	<p>me objekte/vizitime; -Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 20 duke përfshirë edhe numrin 0) ; -Zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e dhëna; -Zbaton mbledhjen dhe zbritjen në problema me fjalë (në situata reale); -Përcakton radhën (numrat rendorë); -Vizaton vijat e drejta, të lakuara, të hapura dhe të mbyllura;</p>	<p>dhe zbritje(P)fq. 60,61 49.Vlerësoj më atë që mësuam fq63 50.Vijat e drejta dhe të lakuara (Zh) fq.63 51.Pikat si prerje e vijave(Zh)f q.64 52.Vijat e hapura dhe të mbyllura (Zh) fq.65 53.Segment i (Zh) fq.66 54. Segmenti (U) fq.67 55.Figurat dhe format e njëjta (Zh) fq.68 56. Figurat dhe format e njëjta (U) fq.69 57.Numri gjashtë (Zh) fq.70</p>	<p>*Mësim-dhënia dhe të nxënit e integruar  *Mësim-dhënia dhe të nxënit e diferencuar  <b>Metodat:</b> Ilustrimit Demonstrimit Bashkëbisedimit Modelimit <b>Teknikat:</b>  Stuhi mendimësh Rrjeti i diskutimit Kllaser</p>	<p><i>Lista e kontrollit</i>  <i>Portfolio</i></p>	<p><b>Çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore</b>  -Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm  -Edukimi për qytetari demokratik e</p>	
--	---	--	--	--	---	--

		<p>58.Numri shtatë (Zh) fq.71</p> <p>59.Numri 6 dhe 7 (U) fq.72</p> <p>60.Mbledhja e numrave deri në shtatë (Zh) fq.73</p> <p>61.Mbledhja e numrave deri në shtatë (U) fq.74</p> <p>62.Zbritja e numrave deri në shtatë(Zh) fq.75</p> <p>63.Mbledhja dhe zbritja e numrave deri në shtatë(U) fq.76,77</p> <p>64.Detyratë ndryshme lidhur me mbledhjen dhe zbritjen (P) fq.78</p> <p>65.Vlerësojmë atë që mësuam fq.79</p>		<p>Punë e drejtuar (me tekstet mësimore dhe ilustrime të përgatitura nga mësuesja)</p>		
--	--	---	--	--	--	--

			<p>66.Numri tetë-8 (Zh) fq.80</p> <p>67. Numri tetë-8 (U) fq.81</p> <p>68.Numri nëntë-9 (Zh) fq.82</p> <p>69.Numri nëntë-9 (U) fq.83</p> <p>70.Mbledhja dhe zbritja e numrave deri në nëntë(Zh) fq.85,86</p> <p>71. Mbledhja dhe zbritja e numrave deri në nëntë(U) fq.87,88</p> <p>72.Detyra për përsëritje (P)fq.89,90</p> <p>73.Vlerësoj më atë që mësuam fq.91</p> <p>74.Shuma e tre</p>					
--	--	--	--	--	--	--	--	--

			<p>numrave (Zh) fq.92</p> <p>75. Shuma e tre numrave (U) fq.93</p> <p>76.Ndryshi mi i tre numrave(Z h) fq.94</p> <p>77. Ndryshimi i tre numrave(U) fq.95</p> <p>78.Numri dhjetë-10 (Zh) fq.96</p> <p>79. Numri dhjetë-10 (U) fq.97,98</p> <p>80.Paraqitja e numrave në boshtin numerik (Zh) fq.100</p> <p>81.Mbledhja dhe zbritja e numrave deri në 10 (Zh) fq.101</p>				
--	--	--	--	--	--	--	--

**PLANI TREMUJOR: JANAR-SHKURT-MARS**

**Fusha e kurrikulës: Matematikë      Lënda mësimore: Matematikë      Klasa: I**  
**Tema/t mësimore: 1.Numrat natyrorë ;      2.Figurat gjeometrike;      3.Modelet;**  
**4.Sipërfaqja;      5.Trupat gjeometrik**

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve: I.3 ; II.1,2,3,4,7 ; III.1,2,3,4,5,7 ; IV.2,5 ; V.5,7 ; VI.2,6**

**Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:1.1,3,4,5 ; 2.1 ; 3.1,2,3,6; ; 4.1,2 ; 5.1 ; 6.1,2,3,4 ; 7.1 ; 8.1**

Nr	Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
1	Numrat natyrorë	Lexon dhe shkruan numrat nga 1 deri në 20; -Numëron në rendin rritës dhe zbritës me numrat nga 1 deri në 20;	<b>Muaji janar-shkurt-mars</b>  82.Mbledhja dhe zbritja e numrave deri në 10 (U) fq.102  83.Detyra për përsëritje (P) fq.104,105	58 orë	<b>Metodologjitë:</b>  *Mësimdhënia dhe të nxënit me nxënësin në qendër dhe gjithëpërfshirja	*Vlerësimi i vazhdueshëm  <i>*Vlerësim formativ</i>  <i>Përmes</i>  - <i>vezhgimit</i>  - <i>pjesëmarrjes në aktivitetet</i>	Gjuhët dhe komunikimi  Artet  Matematika  Ed.fiz.sport dhe shëndeti	Mateatika 1a
2	Figurat gjeometrike	-Kupton shenjat; +, -, >, <, =, dhe i përdor ato në rastet e caktuara; - Demonstron të kuptuarit e numrit përmes	83.Detyra për përsëritje (P) fq.104,105  84.Zbatimi i mbledhjes dhe zbritjes(Z) fq.106,107		*Mësimdhënia dhe të nxënit e bazuar në arritjen e kompetencave	- <i>pjesëmarrjes në aktivitetet</i>	Shoqëria dhe mjedisi	Mateatika 1b
3	Modelet					<b>Instrumentet:</b>	Jeta dhe puna	Burime nga interneti

4	Sipërfaqja	shoqërimet me objekte/vizatime;	85.Vlerësojmë atë që mësuam		*Mësimdhënia dhe të nxënit e integruar	<i>Lista e kontrollit</i>		
5	Trupat gjeometrikë	-Përcakton mbledhurin e parë, mbledhurin e dytë, shumën, të zbritshmin, zbritësin dhe ndryshimin e numrave nga 1 deri në 20; -Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 20 duke përfshirë edhe numrin 0) ; -Zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e dhëna; -Zbaton mbledhjen dhe zbritjen në problema me fjalë (në situata	86.Paraja-euro (Zh) fq.5 87. Paraja-euro (U) fq.6,7 88.Figurat-forma dhe ngjyra(Zh) fq.8 89.Figurat në formë të drejtkëndës hit dhe të katrorit(Zh) fq.9 90. Figurat në formë të trekëndëshit dhe të katrorit (Zh) fq.11 91.Detyra për përsëritje(P) fq.13 92.Edhe matematika është zbavitje (Z) fq.14 93.Simetria dhe drejtëza e simetrisë (Zh) fq.15		*Mësimdhënia dhe të nxënit e diferencuar	<i>Portfolio</i>	<b>Çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore</b>	-Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm  -Edukimi për qytetari demokratik e



	<p>reale);  -Tregon paraardhësin, pasardhësin, qëndron ndërmjet, të numrave nga 1 deri në 20;  - Argumenton lidhjen ndërmjet mbledhjes dhe zbritjes së numrave nga 1 deri në 20;  -Zbaton vetinë e ndërrimit dhe të shoqërimit për mbledhjen e numrave nga 1 deri në 20;  -Zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e dhëna;  -Zbaton mbledhjen dhe zbritjen në problema me fjalë (në situata reale);  -Mbledh</p>	<p>94. Simetria dhe drejtëza e simetrisë (U) fq.16,17  95. Për sa është një numër më i madh se tjetri(Zh) fq.18  96. Për sa është një numër më i madh se tjetri(U) fq.19  97. Për sa është një numër më i vogël se tjetri(Zh) fq.20  98. Për sa është një numër më i vogël se tjetri(U) fq.21  99.Edhe matematika është zbavitje (Z) fq.23,24  100.Detyra për përsëritje(P)fq.25  101.Shuma dhe mbledhorët(Zh) fq.26  102. Shuma dhe</p>	<p>Punë e drejtuar (me tekstet mësimore dhe ilustrime të përgatitura nga mësuesja)</p>			
--	---	--	--	--	--	--

	<p>dhe zbrit paratë ( përdor monedhën euro);</p> <p>-Emërton figurat gjeometrike siç janë: trekëndëshi , katrori, drejtkëndëshi dhe rrethi;</p> <p>-Vizaton me dorë të lirë katrorin, trekëndëshin dhe figura të tjera;</p> <p>-Tregon shembuj të tjerë që ngjasojnë me figura gjeometrike ;</p> <p>-Ngjyrosë figurën simetrike dhe krijon figura simetrie;</p> <p>-Ngjyros figurën simetrike dhe krijon figura simetrie;</p> <p>-Vizaton</p>	<p>mbledhorët( U) fq.27 103.I zbritshmi, zbritësi dhe ndryshimi (Zh) fq.28 104. I zbritshmi, zbritësi dhe ndryshimi (U) fq.29 105.Ndërimi i vendeve të mbledhorëve(Zh) fq.30,31 106. Ndërimi i vendeve të mbledhorëve(U) fq.32 107.Lidhja në mes mbledhjes dhe zbritjes (Zh) fq.33 108. Lidhja në mes mbledhjes dhe zbritjes (U) fq.34 109.Zbërthimi i numrave në mbledhorë(Zh) fq.35,36 110. Zbërthimi i numrave në mbledhorë(U) fq.37</p>					
--	---	---	--	--	--	--	--

	<p>figurën e radhës duke vëzhguar vargun e figurave paraprake;</p> <p>-Modelon katrorin dhe drejtkëndës hin me plastelinë dhe mjete të tjera;</p> <p>-Klasifikon objektet sipas vetive të tyre;</p> <p>-Ngjyrosë sipërfaqet brenda figurave të ndryshme (katrori, drejtkëndëshi, trekëndëshi, rrethi);</p> <p>-Dallon sipërfaqen brenda, jashtë dhe në figurë;</p> <p>-Emërton trupat gjeometrik (kubi, kuboidi, sfera);</p> <p>-Krahason trupat</p>	<p>111.Detyra për përsëritje(P) fq.38</p> <p>112.Numrat deri në 20(Zh) fq.40</p> <p>113.Numrat prej 11deri në 20(Zh) fq.41</p> <p>114.Numrat deri në 20(U)fq.42, 43</p> <p>115.Mbledhja e numrave deri në 20 (Zh) fq.44,45</p> <p>116.Mbledhja e numrave deri në 20 (U)fq.46</p> <p>117.Zbritja e numrave deri në 20 (Zh) fq.47</p> <p>118. Zbritja e numrave deri në 20 (U) fq.48</p> <p>119.Mbledhja dhe zbritja e numrave deri në 20 (Zh) fq.49</p> <p>120. Mbledhja dhe zbritja</p>				
--	--	---	--	--	--	--

	<p>gjeometrik (përmasat e tyre);</p> <p>-Identifikon objekte të ngjashme me kubin, kuboidin dhe sferën;</p> <p>-Gjen (bën) dallimet ndërmjet figurave gjeometrike dhe trupave gjeometrik;</p>	<p>e numrave deri në 20 (U) fq.50</p> <p>121.Detyra për përsëritje (P) fq.51,52</p> <p>122.Zbatim i i mbledhjes dhe i zbritjes(Z) fq.53</p> <p>123.Detyra lidhur me mbledhjen dhe zbritjen(U) fq.54,55</p> <p>124.Detyra për përsëritje(P) fq.56</p> <p>125.Vlerësojmë të kuptuarit(V) fq.57</p> <p>126.Kubi dhe Kuboidi(Zh)fq.58</p> <p>127. Kubi dhe Kuboidi (U) fq.59</p> <p>128.Cilindri ,Koni dhe Sfera (Zh) fq.60</p> <p>129. Cilindri, Koni dhe Sfera (U) fq.61</p>					
--	---	--	--	--	--	--	--

			<p>130.Kllapat (Zh) fq.62 131. Kllapat(U) fq.63 132.Detyra për përsëritje(P ) fq.64 133.Mbledh ja dhe zbritja duke plotësuar 10(Zh) fq.65 134. .Mbledhja dhe zbritja duke plotësuar 10(U) fq.66,67 135.Zbritja si veprim i kundër i mbledhjes( Zh) fq.68,69 136. Zbritja si veprim i kundër i mbledhjes (U) fq.70 137.Zbritja e numrave pa e prishur dhjetëshen (Zh) fq.71 138. Zbritja e numrave pa e prishur dhjetëshen (U) fq.72,73</p>				
--	--	--	--	--	--	--	--

			139.Vlerësi m i njohurive (TEST)					
--	--	--	---	--	--	--	--	--

## PLANI TREMUJOR: PRILL-MAJ-QERSHOR

**Fusha e kurrikulës: Matematikë**

**Lënda mësimore: Matematikë**

**Klasa: I**

**Tema/t mësimore: 1. Numrat natyrorë ; dhe inekuacionet lineare;**

**2.Puna me të dhëna ;**

**3.Ekuacionet**

**4. Shprehjet shkronjore; 5. Njësitë matëse**

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve: I.1,3,7,8 ; II.1,2,4,7,8 ; III.1,2,3,4,5,7 ; IV.2,4 ; V.2,5 ; VI.2,6**

**Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen**

**të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve: I.1,3,4,5 ; 2.2,3 ; 3.2,3,4,5,6 ; 4.1,2 ; 5.1 ; 6.4 ; 7.1 ; 8.1,2**

Nr	Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore  (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe dhe situatat jetësore	Buri met
1.	Numrat natyrorë	Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 20 duke përfshirë edhe numrin 0)	<b>Muaji prill-maj-qershor</b>  140.Zbritja e numrave duke veçuar dhjetëshen (Zh) fq.74	46 orë	<b>Metodologjitë:</b>  *Mësimdhënia dhe të nxënit me nxënësin në qendër dhe gjithëpërfshirja	*Vlerësimi i vazhdueshëm  <i>*Vlerësim formativ</i>  <i>Përmes</i>  - <i>vezhgimit</i>  - <i>pjesëmarrjes në aktivitete</i>	Gjuhët dhe komunikimi  Artet  Matematika	Mate matika la
2.	Puna me të dhëna	-Tregon paraardhësin, pasardhësin, qëndron ndërmjet, të numrave nga 1 deri në 20;	141.Zbritja e numrave duke veçuar dhjetëshen (U) fq.75,76		*Mësimdhënia dhe të nxënit e bazuar në arritjen e kompetencave		Ed.fiz.sport. dhe shëndeti	Mate matika 1b
3.	Ekuacionet dhe inekuacionet lineare	numrave nga 1 deri në 20;	142.Zbritja e shumës(Zh) fq.77			<i>Instrumentet:</i>	Shoqëria dhe mjedisi  Jeta dhe puna	Buri me nga interneti

